

Procesverbal
Mbledhja e radhës së Këshillit Bashkiak Skrapar
Mbajtur më datë 29.07.2025

Ora e hapjes së mbledhjes sipas njoftimit 10:30, vendi i mbajtjes së mbledhjes : Salla e mbledhjeve e Këshillit Bashkiak Skrapar, Qendra Kulturore “Riza Cerova” Kati i Dytë.

Listëprezenca e Këshilltarëve pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes.

1. ALMA KADIASI
2. ARJAN HASA m
3. ALBANA HOXHIA Online
4. EDMOND KALEMI m
5. ELSA PETRITAJ
6. ERALD ZAIMI
7. ENVER ÇAKA
8. FIKRET TELHA
9. LIRI NUHELLARI Online
10. MIMOZA HYSAJ
11. MIMOZA ZYLYFTARI
12. MYQERRET HEBIBASI m
13. PËLLUMB GURI
14. SKERDILAJT JAUPLLARI
15. VALBONA GROPA m

Sekretarë e Këshillit deklaroi kuorumin prej 9 Këshilltarësh prezent dhe 2 Këshilltarë online.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nën/Kryetari i Bashkisë z. Altin Lamçe, Përfaqësues të Administratës, të cilët kanë hartuar projekt-vendimet që do të merren në shqyrtim.

Kryetare Këshillit deklaroi hapjen e mbledhjes duke kaluar në pikën 1, miratimi i rendit të ditës sipas njoftimit të bërë me nr.22 prot. të datës 22.07.2025.

Kryetare e Këshillit e cila shprehu se përpara se të kaloj në votim miratimin e rendit të ditës ka një projektvendim shtesë " Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë të paluajtshme, pronë private, që preket nga projekti, "Rikualifikim urban në lagjen "5 Shtatori", Çorovodë, blloku Nr. 1(faza e parë), si dhe diçka shtesë në projektvendimin "Për akordim në investim: Kolaudim punimesh në objektin "Rikonstruksioni i kinemasë Multifunkionale të qytetit të Çorovodës si dhe akordim fonde për blerje të kondicionerëve për nevojat e Bashkisë Skrapar dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike.

Drejtoi pyetjen nëse ka pyetje, diskutime propozime në lidhje me rendin e ditës?

Këshilltarët shprehin dakortësi me rendin e ditës të njoftuar.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e rendit të ditës sipas njoftimit.
Ora 10:35

Vota pro: 11, Alma Kadiasi, Albana Hoxha, Elsa Petritaj, Erald Zaimi, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Mimoza Zylyftari, Pellumb Guri, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

Pika 2 e rendit të ditës , Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Konstituimit të Këshillit Bashkiak, datë 26.06.2025

Kryetare Këshillit u drejtoi pyetjen këshilltarëve nëse ka dikush për të shtuar diçka në lidhje me procesverbalin i cili u është vënë në dispozicion çdo këshilltari së bashku me materialet e mbledhjes së radhës.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së mëparshme . Ora 10:40

Vota pro: 11, Alma Kadiasi, Albana Hoxha, Elsa Petritaj, Erald Zaimi, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Mimoza Zylyftari, Pellumb Guri, Skerdilajt Jaupllari..

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

Pika 3 deklarimet e konfliktit të interesave

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka konflikt interesi nga këshilltarët për çështjet që do të merren në shqyrtim.

Për çështjet që do të meren në shqyrtim asnjë nga anëtarët e këshilltarët nuk ka shprehur konflikt interesi.

Kryetare Këshillit kërkoi nga anëtarët e këshillit pikën nr .8 ta kalonin për votim mbas pikës nr.3

Pika 8 e rendit të ditës “Për shpronësimin, për interes publik të pronarit të pasurisë të paluajtshme, prone private, që preket nga projekti, ‘Rikualifikim urban në lagjen “5 Shtatori”, Çorovodë, blloku nr.1 (faza e 1)”.

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr Nën/Kryetari i Bashkisë z.Altin Lamçe i cili prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes?

Me leje fjalën e merr z.Pëllumb Guri i cili pyet nëse ishte me letra apo jo dhe po u prish çfarë do bëhet?

Me leje fjalën e merr z.Altin Lamçe i cili shpreh se ne e dinim se ishte pa dokumentacion. Por i kishte dokumentat dhe do zgjerohet do bëhet lulishte , do të prishet gardhi rrethues i kopshtit dhe do ketë goxha hapsirë.

Me leje fjalën e merr z. Fikret Telha i cili shpreh se vlera është 571 125 lekë ske çka bënë është në normat e përcaktuara por nga kush dëmshpërblehet? Çfarë është parashikuar tjetër atje?

Me leje fjalën e merr z.Altin Lamçe i cili shpreh se dëmshpërblehet nga bashkia, prandaj ne jemi të detyruar ta miratojmë. Prishje kamë përshtypje nuk do të ketë më. Na ka ndodhur dhe një problem i tillë ne ju dërgojmë qytetarëve paraqisni pranë bashkisë dokumentat e pronësisë dhe pjesa më e madhe dhe sot nuk i kanë sjellë. Kjo na krijon dhe probleme të tjera se kemi dy çështje kemi zbatimin e projektit, i cili kërkon prishjen e këtij objekti dhe lirimin e hapësirave publike të cilat do ti vazhdojmë hap pas hapi se dhe aftësitë logjistike nuk na mbulojnë që ta bëjmë gjithë qytetin njëherësh por atje ku duhet. Që të ndërhyem dhe me ndonjë projekt rehabilitimi qoftë me ndërmarrjen qoftë me projekte të kësaj natyre .

Me leje fjalën e merr z. Fikret Telha i cili pyet nëse ke informacion për rrugën që është hapur te 30 hyrëshi është parashikuar ndonjë gjë?

Me leje fjalën e merr z.Altin Lamçe i cili shpreh se gjatë zbatimit do ti japim një zgjidhje sepse nuk ishte parashikuar as të prishej as të bëhej rrugë e re. Shërbimi kryesor që ne ndërhyem atje ishte pjesa e ujërave në pjesën e sipërme që ishte e pamundur të kaloje gjatë gjithë vitit që kishte rreshje. Meqënëse ndërhyem aty e kishim projektin të bërë dhe në pjesën tjetër dhe menduam se do dali një gjë e bukur.

Me leje fjalën e merr z. Enver Caka i cili pyet pse nuk prishen dhe kioskat tek gjimnazi?

Me leje fjalën e merr z.Altin Lamçe i cili shpreh sepse s’ka dalë akoma VKM. Ne edhe ju jemi pjesë e kërkesës ne bëjmë kërkesën dhe e dërgojmë. Agjencia Shtetërore e Shpronësimeve kontrollon të gjithë dokumentacionin dhe përgatit vlerësimin dhe ua dërgon Ministrive të linjës dhe pastaj me VKM.

Me leje fjalën e merr z. Pëllumb Guri i cili shpreh se të prishësh ato që janë me letra dhe atje me sa di unë ushqehen dy familje dhe ta prishësh thjeshtë se do mbillet bar. Të ngresh biznesin në vend tjetër është e vështirë.

Me leje fjalën e merr z. Altin Lamçe i cili shpreh se ka ambiente me qira plotë, mendoj se hapësirat publike duhet të lirohen se kur diskutojmë hapësirë skemi hapësirë, kur diskutojmë parkim skemi parkim. Ska lidhje as me arkitekturën as me urbanistikën dhe duhet hequr.

Me leje fjalën e merr z. Pëllumb Guri i cili shpreh se këtu sa po vjen dhe po firojnë edhe fëmijët tanë nuk kthehen më këtu dhe kështu do ikin të gjithë.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 10:55

Vota pro: 11, Alma Kadiasi, Albana Hoxha, Elsa Petritaj, Erald Zaimi, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Mimoza Zylyftari, Pellumb Guri, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: : s'ka

Pika 4 e rendit të ditës “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Qershor 2025”.

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projekt-vendimit.

Me leje fjalën e merr znj. Teuta Hysenbelliu e cila prezantoi projekt-vendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes?

Me leje fjalën e merr z. Pëllumb Guri i cili pyet vajza ku është punësuar në punë shteti në bashki?

Me leje fjalën e merr znj. Teuta Hysenbelliu e cila shpreh se nuk është punësuar në bashki, është studente në Tiranë dhe periudhën e pushimeve del e siguruar dhe në momentin që del e siguruar penalizohet. Por kur të largohet nga puna mund të kthehet përsëri në muajin tetor sipas ligjit.

Me leje fjalën e merr z. Pëllumb Guri i cili pyet për personat që marrin pension, mund të marrin shtesë?

Me leje fjalën e merr znj. Teuta Hysenbelliu e cila shpreh nëqoftëse ai deklaron në sistem që ai merr pension nuk penalizohet nga ndihma ekonomike por kryefamiljari nuk llogaritet në masën e ndihmës ekonomike, llogariten vetëm 3 anëtarët e tjerë të familjes.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e rendit të ditës sipas njoftimit. Ora 11:00

Vota pro: 10, Alma Kadiasi, Albana Hoxha, Elsa Petritaj, Erald Zaimi, Enver Caka, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Mimoza Zylyftari, Pellumb Guri, Skerdilajt Jaupllari..

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

Pika 5 e rendit të ditës “Për një ndryshim në VKB nr.32 datë 26.06.2025, për miratimin e transferimit nga zëri i investimeve nga të ardhurat e Bashkisë, objekti:Rikonstruksioni segmenteve rrugore në Njësinë Administrative, në objektin: Asfaltimi rrugës nga Lapidari deri në fshatin Kakruk, Bashkia Skrapar-bashkëfinancim me Këshillin e Qarkut Berat”.

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr z. Neim Gogo i cili prezantoi projekt-vendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes?

Me leje fjalën e merr z. Skerdilajt Jaupllari i cili pyet nëse është e njëjta vlerë?

Me leje fjalën e merr z. Neim Gogo i cili shpreh se është e njëjta vlerë dhe i njëjti objekt.

Me leje fjalën e merr z. Pellumb Guri i cili shpreh se po pati mundësi të bëhej rruga Berat-Skrapar sepse është shumë keq.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 11:10

Vota pro: 10, Alma Kadiasi, Albana Hoxha, Elsa Petritaj, Erald Zaimi, Enver Caka, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Mimoza Zylyftari, Pellumb Guri, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

Pika 6 e rendit të ditës “Për miratimin e tavaneve përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 të Bashkisë Skrapar dhe institucioneve në varës të saj”.

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr z. Neim Gogo i cili prezantoi projekt-vendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes?

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 11:15

Vota pro: 10, Alma Kadiasi, Albana Hoxha, Elsa Petritaj, Erald Zaimi, Enver Caka, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Mimoza Zylyftari, Pellumb Guri, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

Pika 7 e rendit të ditës "Për akordimin e fondit në zërin e investimeve me emërtim :Kolaudim punimesh në objektin "Rikonstruksioni i kinemasë Multifunksionale të qytetit të Çorovodës" si dhe akordim fonde për blerje të kondicionerëve për nevojat e Bashkisë Skrapar dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike.

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projekt-vendimit.

Me leje fjalën e merr z. Neim Gogo i cili prezantoi projekt-vendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes?

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 11:25

Vota pro: 10, Alma Kadiasi, Albana Hoxha, Elsa Petritaj, Erald Zaimi, Enver Caka, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Mimoza Zylyftari, Pellumb Guri, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

Të ndryshme

Me leje fjalën e merr z. Pellumb Guri i cili shpreh diskutim për udhëtimin që do bëjmë kur dhe çfarë vendi. Plus edhe për laptopat që diskutuam herën e kaluar në mbledhje si do bëhet që mos të meremi më me letra.

Fjalën e merr z. Neim Gogo i cili bën një sqarim se salla do të rikonceptohet por që të bëhet kjo duhen specialistë të fushës për ta bërë këtë gjë. Do kontaktojmë dhe me një studio sepse materialet, çdo gjë do jenë të kohës, që secili të ketë mikrofonin e vetë.

Kryetare e Këshillit e deklaroi përfundimin e mbledhjes .

Sekretare Këshillit Bashkiak: Xheni Çela



Kryetare Këshillit Bashkiak: Elsa Petritaj



Këshilltarët që firmosin procesverbalin:

1. Alma Kadiasi



2. Fikret Telha



3. Skerdilajt Jaupllari

